



Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) është një prokurori e ndërkombëtarizuar dhe e zhvendosur në Hagë, që u krijua për hetimin dhe, nëse është e përligjur, për ndjekjen penale të individëve për krimet e pretenduara në Raportin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës (APKE) të vitit 2011 me titull “Trajtimi çnjerëzor i personave dhe trafikimi i paligjshëm i organeve njerëzore në Kosovë”.

#### MANDATI

Mandati i ZPS-së përcaktohet në Ligjin për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar miratuar nga Kuvendi i Kosovës në gusht të vitit 2015

Ky ligj e autorizon ZPS-në të hetojë dhe ndjekë penalisht shtetas të Kosovës dhe/ose Republikës Federale të Jugosllavisë, apo persona të cilët kanë kryer krime kundër shtetasve të Kosovës dhe/ose Republikës Federale të Jugosllavisë, për krime të nisura ose të kryera në Kosovë që lidhen me sjelljet dhe veprimet e përmendura në Raportin e APKE-së gjatë periudhës trevjeçare nga 1 janari 1998 deri më 31 dhjetor 2000.

#### KONTAKTI

Për informacion më të gjerë, ju lutemi kontaktoni Zyrën e Prokurorit të Specializuar në:  
[spokespersonSPO@scp-ks.org](mailto:spokespersonSPO@scp-ks.org) ose me letër në adresën postare:

Raamweg 47  
2596 HN The Hague  
The Netherlands

#### PROKURORI I SPECIALIZUAR



Prokurore e Specializuar është Kimberli Uest (Kimberly West), ish-prokurore federale në SHBA me përvojë të gjerë në hetimet penale si në nivel shtetëror ashtu edhe ndërkombëtar. Mandati i saj filloi në tetor të vitit 2023.

Znj. Uest është e treta në postin e Prokurorit të Specializuar dhe vjen pas Xhek Smithit (Jack Smith), gjithashtu prokuror amerikan, i cili shërbeu gjatë periudhës shtator 2018 - nëntor 2022.

I pari Prokuror i Specializuar ishte Dejvid Shvendiman (David Schwendiman), një tjetër prokuror amerikan, i cili e mbajti këtë post nga shtatori 2016 deri në mars 2018. Më herët, në periudhën nga maj 2015 deri në gusht 2016, ai shërbeu si Kryeprokuror i Task Forcës Hetimore Speciale (TFHS).

Kryeprokurori i parë i TFHS-së ishte ambasadori Klint Uilliamson (Clint Williamson), ish ambasador i SHBA-së për çështje të krimeve të luftës, i cili shërbeu në TFHS nga tetori 2011 deri në gusht 2014.

## HETIMI

E themeluar më 1 shtator 2016, ZPS-ja trashëgoi punonjësit dhe mandatin e Task Forcës Hetimore Speciale (TFHS), e cila kishte filluar hetimin e pretendimeve të Raportit të APKE-së në tetor 2011 si një subjekt i pavarur, juridiksioni dhe autoriteti ligjor i së cilës buronte nga Vendimi i Këshillit të Bashkimit Evropian për themelimin e Misionit të BE-së për Shtetin Ligjor në Kosovë (EULEX).

Prokurori i Specializuar ka kompetenca për sa vijon:

- të marrë në pyetje viktime, dëshmitarë dhe të dyshuar dhe të regjistrojë deklaratat e tyre;
- të kryejë hetime në vendngjarje, të mbledhë prova, të ndërmarrë ekspertiza dhe të kryejë veprimtari të tjera hetimore, sipas nevojës;
- të kërkojë ndihmë prej vendeve të treta, organizatave ndërkombëtare dhe subjekteve të tjera; dhe
- të ndërmarrë masa hetimore, siç përcaktohet në Rregulloren e Procedurës dhe të Provave..

Për të ruajtur integritetin e hetimeve, konfidencialitetin e dëshmimeve të dëshmitarëve dhe mbledhjen në vijimësi të provave, ZPS-ja nuk jep informacione konkrete në lidhje me statusin e hetimeve, provat e mbledhura gjatë hetimit ose kohën e ngritjes së akuzave të mundshme.

## HISTORIKU

APKE-ja emëroi senatorin Marti (Marty) që të hetonte pretendimet e paraqitura në kujtimet e ish-kryeprokurores së Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ) Karla Del Ponte (Carla Del Ponte), me titull "Zonja Prokurore", që u botuan në prill 2008.

Pas publikimit të Raportit Marti, Bashkimi Evropian krijoi TFHS-në për të hetuar pretendimet që përmbante Raporti. Ligji për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar mundësoi mekanizmin për vazhdimin e hetimeve dhe procedimin penal të akuzave që do të dilnin nga hetimet. ZPS-ja është pjesë e sistemit gjyqësor të Kosovës, por e vendosur në Vendet e Ulëta ( Holandë), në bazë të Marrëveshjes me Shtetin Pritës, midis Vendeve të Ulëta (Holandës) dhe Kosovës, të datës 15 shkurt 2016. Është një institucion i përkohshëm me mandat dhe juridiksion specifik që përfshin krime kundër njerëzimit, krime lufte, dhe krime të tjera të parapara në legjislacionin e Kosovës, të cilat pretendohet se kanë ndodhur midis 1 janarit 1998 dhe 31 dhjetorit 2000.

## PËRPARËSIA KUNDREJT GJYKATAVE TË TJERA

Dhomat e Specializuara kanë përparësi kundrejt të gjitha gjykatave të tjera në Kosovë. Dhomat e Specializuara ose ZPS-ja mund të urdhërojnë transferimin e procedurave brenda juridiksionit të tyre prej çdo prokurori apo gjykatë tjetër në territorin e Kosovës tek Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe ZPS-ja, në çfarëdo faze të hetimeve apo të proceseve gjyqësore. Dhomat e Specializuara dhe ZPS-ja mund t'i japin urdhër një gjykatë në Kosovë, t'u dorëzojnë çfarëdo çështje gjyqësore apo hetimi në kryerje e sipër që përfshihet në juridiksionin dhe mandatin e Dhomave të Specializuara ose të ZPS-së..

Të gjitha gjykatat dhe të gjithë prokurorët e Kosovës duhet të njoftojnë pa vonesë Dhomat e Specializuara he ZPS- në nëse janë në dijeni të ndonjë rasti procedurash penale që përfshihet në juridiksionin e Dhomave të Specializuara.

## PERSONELI

Punonjësit e ZPS-së - prokurorët, hetuesit, analistët, personeli i sigurisë, specialistët për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe personeli mbështetës - janë ndërkombëtarë, shtetas të vendeve anëtare të BE-së ose të një prej pesë vendeve kontribuese që nuk janë anëtarë të BE-së: Kanadaja, Norvegjia, Zvicra, Turqia dhe Shtetet e Bashkuara.

## DOKUMENTE KRYESORE

- Raporti i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës i janarit 2011, me titull "Trajtimi çnjerëzor i personave dhe trafikimi i paligjshëm i organeve njerëzore në Kosovë".
- *Ligji për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare ("Shkëmbimi i Letrave") miratuar nga Kuvendi i Kosovës në prill 2014*
- Kushtetuta dhe Amendamenti Kushtetues, neni162: Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar, miratuar nga Kuvendi i Kosovës në gusht 2015
- *Ligji për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar miratuar nga Kuvendi i Kosovës në gusht 2015*
- Marrëveshja midis Mbretërisë së Vendeve të Ulëta (Holandës) dhe Republikës së Kosovës për Vendosjen e Selisë së Institucionit Gjyqësor të Specializuar të Zhvendosur të Kosovës në Vendet e Ulëta (Holandë) (Marrëveshja me Shtetin Pritës) e shkurtit 2016
- Rregullorja e Procedurës dhe e Provave e Dhomave të Specializuara, miratuar nga gjykatësit e Dhomave të Specializuara, e cila hyri në fuqi në korrik 2017